



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:046887

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06594125

C - III - 12 – 0562

Paditësi:

P G B nga fshati G Komuna e Prizrenit.

Kundër:

E paditura:

KBI "Progres Export"; NSH "Blegtoria dhe Lavërtaria", Lagjja Arbana, Komuna e Prizrenit, e cila është nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Ndërhyrësit në anën e paditësit :

K F B dhe J P B që të dy nga fshati G Komuna e Prizrenit.

Objekti i çështjes : Vërtetimi i nulitetit të kontratës mbi ndërrimin e patundëshmërive etj .

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), Kolegji i Specializuar në përbërje nga gjykatësi, Agron J. Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatësja, Manushe Karaqi, dhe gjykatësi, Sylejman Shumolli, pas seancës vendimmarrëse, të mbajtur me dt.10.12.2024, dhe i hartuar me shkrim me dt.13.12.2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM
PËR MOSPARAQITJE**

I. HUDHET kërkesëpadia e paditësit, P G B nga fshati G Komuna e Prizrenit në çështjen juridike kontestimore, **C - III - 12 – 0562** dhe atë për shkak të mos paraqitjes në seancën dëgjimore.

II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Paditësi, me dt.04.01.2005, fillimisht në Gjykatën Komunale në Prizren, ka paraqitur padinë kundër të paditurave, Kombinati Bujqësor Industrial, (KBI), "Progres Export" me seli në

Arbanë, Prizren e cila është nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, dhe atë për vërtetimin e nulitetit të kontratës mbi ndërrimin e patundshmërive, Leg.nr.. të dt.. shkurt ., vërtetimi i pronësisë mbi paluajtshmërinë, regjistrimi në kadastër si dhe dorëzimi në posedim dhe shfrytëzim të lirë i patundshmërisë dhe kthimin e patundshmërisë dhe se kjo lëndë, ka qenë e evidentuar si, C.nr.1/2015 në Gjykatën Komunale në Prizren.

Paditësi, në këtë padi, ka theksuar se babai i tyre, L I G B ish nga fshati G komuna e Prizrenit, deri më 21 Dhjetor 1964, ishte pronar i patundshmërisë, nr., në vendin e quajtur, "... kulturë arë, klasë e katërt, sipërfaqe prej 1,53.50 ha dhe shtëpisë prej 50 m², e cila evidentohet në bazë të listës poseduese numër . KK G, dhe si provë ka cekur Vërtetimin e KK Prizren, Drejtorisë për Çështje Pronësore – Juridike, Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren, Nr.023 – 576/1 të dt.8 Nëntor 2003, se e paditura, KBI' 'Progres' ' në Prizren, me dhunë ia kanë marrë patundshmërinë e precizuar më lartë, pronarit të ndjerit, L I G B, duke e maltretuar fizikisht në polici dhe atë sipas urdhërësës së funksionerëve të atëhershëm politik të Prizrenit, me ç' rast është maltretuar fizikisht dhe psikikisht edhe në Bashkësinë Lokale të G, dhe pa trysnisë fizike e psikike me dhunë është arritur qëllimi i nënshkrimit të kontratës për ndërrimin e patundshmërisë së tij lëndore me Komunën e Prizrenit, andaj i ndjeri, L I G B, nën trysni dhe kundër vullnetit të tij, ka qenë i detyruar që t'a nënshkruaj kontratën për ndërrimin e patundshmërive, Leg.nr.. të dt.. shkurt ., sipas së cilës ai i ka ndërruar patundshmëritë: ngastrën kadastrale. nr., sipas listës poseduese numër ., KK G., me patundshmërinë në ngastrën kadastrale, nr.. dhe nga Lista poseduese nr., ZK A e më gjerësisht si në këtë padi.

Me dt.19.06.2012, pran DhPGjSK-së, av. Z B nga Prishtina, i është drejtuar DhPGjSK-së me parashtrësën e dt.08.06.2012 e përmes së cilës ka njoftuar gjykatën për pjesëmarrjen e personave të tretë, K F B dhe J P B, në procesin kontestimorë – ndërhyrësve e së cilës parashtrësë ia ka bashkangjitur autorizimin e tij për përfaqësim të tyre në këtë lëndë.

Me dt.16.10.2024, DhPGjSK-ja, pas ndërmarrjes së veprimeve procedurale, me aktvendimin e saj, C – III.- 12 – 0562 të dt.16.10.2024, ka pranuar si të bazuar propozimin e personave të tretë, K F B dhe J P B nga fshati G Komuna e Prizrenit, që si pjesëmarrës në procesin kontestimor dhe në çështjen juridike kontestimorë, C - III - 12 – 0562, të jenë ndërhyrës në anën e paditësit, P G B nga fshati G Komuna e Prizrenit.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), me Kolegjin e saj për vendimmarrje, e me qëllim të dhënies së mundësisë për palët ndërgjyqëse, që t'i paraqesin argumentet e tyre, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me datën 10 Dhjetor 2024, në orën 1:30 min dhe se pala paditëse, urdhrin e gjykatës për pjesëmarrje në seancë më 10 Dhjetor 2024, së bashku me ftesën për këtë seancë dëgjimore, e ka pranuar me dt.12.11.2024 derisa edhe ndërhyrësit, secili veç e veç, urdhrin e gjykatës për pjesëmarrje në seancë më 10 Dhjetor 2024, së bashku me ftesën për këtë seancë dëgjimore, e kanë pranuar po ashtu me dt.12.11.2024 mirëpo të njëjtit nuk janë paraqitur në seancën dëgjimore të caktuar për datën 10 Dhjetor 2024 me fillim në ora 13 : 30 min, si dhe se as paditësi por as ndërhyrësit, nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë në gjykatë për të shtyrjen e seancës për ndonjë datë tjetër si dhe mos ardhjen - mos prezencën e tyre, nuk e kanë arsyetuar.

Në seancën dëgjimore, pasi konstatimeve gjegjëse, dhe pasi që përfaqësuesi i AKP-së, deklaroi se pas konstatimeve të gjykatës palët paditëse dhe ndërhyrësit, janë ftuar në mënyrë të rregullt

dhe mos prezencën nuk e kanë arsyetuar, i ka propozuar gjykatës në kuptim qe neni 58 Ligji për Dhomën e Posaçme, të merret aktgjykim për mosparaqitje e më pas kolegji i kësaj gjykata mori aktvendim e me të cilin, e aprovoj propozimin e përfaqësuesit të paditurës, AKP-së për nxjerrjen

e aktgjykimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit, P G B nga fshati G Komuna e Prizrenit, dhe ndërhyrësve në anën e paditësit, K F B dhe J P B nga fshati G Komuna e Prizrenit e të cilët janë ftuar në mënyrë të rregullt por mosprezencën e tyre, nuk e kanë arsyetuar si dhe se kolegji i kësaj gjykatë, vendosi që jashtë seancës dëgjimore, aktgjykimin për mos paraqitje, do t'ua hartoj dhe të njëjtën aktgjykim, do t'ua përcell palëve në procedure brenda afatit të paraparë ligjor .

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor :

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Ligji i Dhomës së Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), Kolegji, vendosi të mbaj seancën dëgjimore mirëpo për shkak të mos pjesëmarrjes së palës paditëse dhe ndërhyrësve në anën e paditësit, në seancën dëgjimore të dt.10 dhjetor 2024, edhe pse të ftuara në mënyrë të rregullt, gjykata mori aktgjykim për shkak të mos paraqitjes dhe e hodhi poshtë kërkesëpadinë e paditësit, P G B nga fshati G Komuna e Prizrenit, dhe ndërhyrësve në anën e paditësit, K F B dhe J P B nga fshati G Komuna e Prizrenit dhe atë për shkak të mos pjesëmarrjes së tyre, si palë paditëse gjegjësisht si ndërhyrës në anëme paditësit në seancën dëgjimore.

Kolegji i DhPGjSK-së, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dhe pasi që përfaqësuesi i AKP-së, i ka propozuar gjykatës në kuptim qe neni 58 Ligji për Dhomën e Posaçme, të merret aktgjykim për mosparaqitje e më pas kolegji i kësaj gjykata mori aktvendim e me të cilin, e aprovoj propozimin e përfaqësuesit të paditurës, AKP-së për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit, P G B nga fshati G Komuna e Prizrenit, dhe ndërhyrësve në anën e paditësit, K F B dhe J P B nga fshati G Komuna e Prizrenit e të cilët janë ftuar në mënyrë të rregullt por mosprezencën e tyre, nuk e kanë arsyetuar por se të njëjtit nuk janë paraqitur në këtë seancë dëgjimore si dhe nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë në gjykatë për të shtyrë seancën për ndonjë datë tjetër si dhe mosardhjen – mos prezencën e tyre nuk e kanë arsyetuar dhe se në seancën dëgjimore të mbajtur më datën e cekur më lartë, përfaqësuesi i palës së paditur, AKP-së, i propozoi gjykatës që në bazë të nenit 58 par.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, gjykata të nxjerr aktgjykim për mosparaqitje dhe se kolegji gjykues i DhPGjSK-së, në seancë dëgjimore mori aktvendim me të cilin e aprovoi kërkesën e përfaqësuesit të AKP-së që të merret vendim në mungesë të palës paditëse dhe ndërhyrësve në anën e tij.

Në bazë të nenit 58 paragrafi 2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parashihet që: *''Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimi të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një aktgjykim për mosparaqitje kundër parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale'*. Duke qenë se av.Z B nga Prishtina, dhe av. N K nga Prizreni,

të autorizuarit e paditësit, dhe ndërhyrësve me parashtruesat gjegjëse, i janë revokuar autorizimet e tyre të dhëna nga paditësi dhe ndërhyrësit në anën e tij kurse ftesat për seancën dëgjimore të dt.10 Dhjetor 2024, u janë dërguar personalisht të njëjtëve dhe ata janë ftuar sipas rregullit përkatësisht se pala paditëse, urdhrin e gjykatës për pjesëmarrje në seancë më 10 Dhjetor 2024, së bashku me ftesën për këtë seancë dëgjimore, e ka pranuar me dt.12.11.2024 derisa edhe ndërhyrësit, në anën e tij, secili veç e veç urdhrin e gjykatës për pjesëmarrje në seancë më 10

Dhjetor 2024, së bashku me ftesën për këtë seancë dëgjimore, e kanë pranuar po ashtu me dt.12.11.2024 por se të njëjtit nuk janë paraqitur në seancën dëgjimore të caktuar për datën 10 Dhjetor 2024 me fillim në ora 13 : 30 min, si dhe se as paditësi por as ndërhyrësit, nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë në gjykatë për të shtyrjen e seancës për ndonjë datë tjetër si dhe mos ardhjen - mos prezencën e tyre, nuk e kanë arsyetuar edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt, andaj me arsyet e cekura më lartë, Kolegji i kësaj gjykate, edhe mori aktgjykim për shkak të mos paraqitjes.

Shpenzimet Gjqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit, nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), gjykata vendosi që secila palë do t'i bartë shpenzimet e veta të procedurale në këtë çështje juridike kontestimore pasi që e paditura, AKP me seli në Prishtinë, nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv e në bazë të nenit 54 dhe nenit 58, paragrafi 2 të Ligjit nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2023:046887, 13.12.2024

Kolegji i shkallës së I-rë i DhPGjSK-së

Agron J. Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Manushe Karaqi, gjykatëse _____

Sylejman Shumolli, gjykatës _____

KËSHILLË JURIDIKE : Në kuptim të nenit 59 të Ligjit, Nr.06/L – 086 të Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), cilado palë kundër së cilës është nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje nga Dhoma e Posaçme, mund të parashtrorë një kërkesë në Dhomën e Posaçme për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje. Kërkesa për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje duhet të parashtrohet brenda një muaji nga dita e dorëzimit të aktgjykimit për mosparaqitje te pala paditëse. Kërkesa u dorëzohet palëve tjera. Pas dorëzimit të kërkesës, gjyqtari kryesues apo gjyqtari i vetëm përcakton një afat kohor brenda së cilit pala tjetër mund të paraqet argumentet kundërshtuese me shkrim, nëse ka ndonjë të tillë